L I G J
Nr.7932, datë 17.5.1995

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 12, shkronja "b", shprehja "në mënyrë të detyrueshme" zëvendësohet me shprehjen "nga sigurimi i detyrueshëm".

Neni 2

Në nenin 13, pika 3, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Inspektorët e kontributeve të sigurimeve shoqërore kanë të drejtë të kontrollojnë në ndërmarrje, firma, institucione e subjekte të tjera ekonomike masat e kontributeve të derdhura, fondin e pagave dhe listëpagesat".

Neni 3

Në nenin 15 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Këshilli i Ministrave përcakton mënyrën dhe procedurën e derdhjes së kontributeve".

Neni 4

Në nenin 16 bëhen këto shtesa e ndryshime:
1. Në pikën 1 dhe 2, rreshti i parë, pas fjalës "gjobë" shtohen fjalët "dhe kamatëvonesë".
2. Pika 3 ndryshohet si vijon:
"3. Gjobat në kushtet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni për personat përgjegjës do të jenë nga 5 000 deri në 10 000 lekë.Gjobat caktohen nga inspektorët e agjencive të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe ekzekutimi i tyre bëhet në përputhje me ligjin nr.7696, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative" (i ndryshuar)."
3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
"4. Kamatëvonesat e vëna në kushtet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni do të jenë 0.5 për qind për ditë të shumës së papaguar të kontributeve, duke filluar nga dita kur pagesa duhet të ishte bërë."

Neni 5

Në nenin 35 në fund të pikës 1 shtohen 3 paragrafe me këtë përmbajtje:
"Në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë.
Kundër vendimit të KMCAP-it të rrethit personi mund të ankohet në KMCAP-in epror pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, vendimi i të cilit përsa i përket caktimit të aftësisë për punë është i formës së prerë.
Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve caktohen me rregullore të ISSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit".

Neni 6

Në nenin 40 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, pas shprehjes “të të siguruarit që vdes” shtohet shprehja “brenda vitit kalendarik pas mbarimit të sigurimit”.

2. Shkronja “ç” e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“Prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë; prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t’i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë”.

Neni 7

Në nenin 41, pas paragrafit të parë të shkronjës “b”të pikës 1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur nuk merret pension i parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni, masa e pensionit për jetimin është 50 për qind”.

Neni 8

Në nenin 88, pika 7, pas shprehjes “që i është llogaritur pensioni” shtohet shprehja:

“Por jo më shumë se kufiri maksimal i pensionit të pleqërisë të caktuar në ligjin nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore shtetërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me rritjet përkatëse)”.

Neni 9

Në nenin 95 pas paragrafit të dytë të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Pas vitit 2004, personi i siguruar për një kohë më pak se 35 vjet dhe më shumë se 20 vjet sigurim, ka të drejtë të përfitojë pension të pjesshëm kur të arrijë moshën 60 vjeç”.

Neni 10

Në nenin 96 bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 96, paragrafi i parë, hiqen fjalët “ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me gjithë ndryshimet e mëvonshme të tij, dhe zëvendësohen me fjalët “këtij ligji”.

2. Në paragrafin e fundit fjalia “Në rastet e tjera pensioni...” del paragraf më vete dhe ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Në rastet e tjera pensioni do të caktohet me kriteret e këtij ligji. Niveli bazë caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 11

Në nenin 97 pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Punonjësit e nëntokës që janë në marrëdhënie pune në nëntokë më 1.1.1995 dhe kanë plotësuar periudhën e sigurimit sipas nenit 92 të këtij ligji, pavarësisht nga mosha, me kërkesë të tyre marrin pension të parakohshëm në masën 60 për qind të pagës mesatare mujore që nxirret nga shuma e përgjithshme e pagave të marra gjatë 3 vjetëve rresht brenda 10 vjetëve të fundit të punës. Afati i paraqitjes së kërkesës për këtë pension është deri në datën 31.12.1995.Pensioni nuk mund të jetë më i lartë se kufiri maksimal i pensionit të pleqërisë”.

Neni 12

Këshilli i Ministrave mund të vendosë që pensionistët e punësuar ose të vetëpunësuar në

sektorin privat gjatë periudhës së tranzicionit të tërheqin pensionin mujor të pleqërisë dhe të derdhin kontribut për kohën që kryejnë veprimtari ekonomike.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1109, datë 30.5.1995, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha